

Seri e testeve COVID-19 në shkolla «Testim i gjerë në Baselland»

Të dashur prindër, të dashur edukatorë të autorizuar

Më poshtë do të gjeni informacione të rëndësishme në lidhje me testin e pështymës të COVID-19 në klasën shkollore të fëmijës suaj. Testi zhvillohet çdo javë dhe është vullnetar. Pëlqimi i dhënë mund të anulohet në çdo kohë dhe pa dhënë arsye. Ju lutemi t'i përmbaheni masave të tanishme në fuqi mbrojtëse të BAG-së (Ministria Federale e Shëndetësisë) dhe të shkollës suaj.

Pranimi i rezultatit të testit të përbashkët:

- Koha e nevojshme për të marrë rezultatin e testit të përbashkët luhetet dhe varët nga faktorë të ndryshëm (nga ngarkesa e punës laboratorike, nga transporti). Mësuesi i klasës zakonisht mund të presë rezultatin brenda një maksimumi kohorë nga 6 deri në 10 orë.
- Më pas rezultatin do të merrni nga shkolla nëpërmjet rrugëve të përcaktuar më parë (Email-it, telefonit, njoftimit individual, etj.).

Rezultati negativ i përbashkët (COVID-19 nuk zbulohet)

Asnjë COVID-19 nuk u zbulua në klasa. Ju lutemi motivoni fëmijën tuaj që të vazhdojë të marrë pjesë në programin «Testim i gjerë në Baselland» në përputhje me udhëzimet e shkollës.

Rezultati pozitiv i përbashkët (COVID-19 u zbulua):

- Drejtorja e shkollës mund ta transferojë klasën në mësimin në distancë (vendimi merret nga drejtorja e shkollës).
- Pjesëmarrësit në klasa bëjnë testin e detyrueshëm diagnostikues PCR (testi i pështymës) sa më shpejt të jetë e mundur në stacionin e sqarimit dhe të testimit në Muttenz ose në një nga stacionet e jashtme.
- Informatat për kohën e punës dhe të udhëzimeve për në stacionin e sqarimit dhe të testimit në Muttenz dhe në stacionet e jashtme mund t'i merrni në www.bl.ch/massentest.
- Udhëzimet për sjelljen tuaj pas këtij testi PCR do t'i merrni menjëherë pas testit.
- Asnjë test i shpejtë i antigenit nuk mund të kryhet për të vërtetuar (shpërndarjen e klasës) rezultatet individuale.
- Shpenzimet për ekzaminim diagnostik në stacionin e sqarimit dhe të testimit në Feldreben ose në njërin nga stacionet e jashtme barten nga Qeveria Federale dhe lajmërimi është i detyrueshëm.